

**MBI**  
**ZBATIMIN E AKTEVE LIGJORE E NORMATIVE, PËR PËRDORIMIN E ARMËVE TË**  
**ZJARRIT NGA PERSONELI I GARDËS SË REPUBLIKËS**

### **I.Të përgjithshme**

Në kuptim të ligjit dhe akteve të tjera nënligjore termat e mëposhtëm kanë këto kuptime si vijon:

1. *“Armë në përdorim individual”*, pistoleta e shërbimit për përdorim individual, që çdo punonjës i Gardës ka të drejtë ta mbajë me vete dhe jashtë orëve të shërbimit.
2. *“Armë të njësisë”*, armët e zjarrit që mbahen/ruhen në magazinën e armatimit dhe u jepen punonjës i Gardës përpara fillimit të shërbimit dhe që nuk mbahen me vete jashtë shërbimit.
3. *“Rregulla për mbajtjen e armës së zjarrit”*, tërësia e normave për këtë shërbim (armatimi) sipas përcaktimeve në Rregulloren e Brendshme të Gardës, Udhëzimeve dhe Urdhrave të Komandantit të Gardës, dhe instruktazheve për këtë qëllim.

### **II.Kushtet e përdorimit të armës**

1. Punonjësit e Gardës mund ta përdorin armën e zjarrit të shërbimit, në ushtrim të detyrave të tyre dhe në përputhje me dispozitat e Ligjit “Për përdorimin e armëve të zjarrit” dhe të nenit 25 të Ligjit “Për Gardën”, vetëm atëherë kur është absolutisht e domosdoshme dhe vetëm si mjet i fundit për të parandaluar ose neutralizuar veprimet e dhunshme të rrezikshme të personit me rrezikshmëri të lartë për jetën dhe shëndetin e tij dhe personave të tretë (*P.L.SH apo kolegë*), kur mjetet e tjera të përdorimit të forcës nuk kanë dhënë rezultat ose nuk arrijnë objektivat e ligjshëm të detyrave funksionale.
2. Shmangia e një rreziku nëpërmjet përdorimit të armëve të zjarrit nga punonjësit e Gardës, bëhet për të mbrojtur jetën, shëndetin e tyre ose të një tjetri (*P.L.SH, kolegë*) nga një sulm i padrejtë, i vërtetë dhe i çastit, me kusht që karakteri i mbrojtjes të jetë në proporcion me rrezikshmërinë e sulmit, si dhe kur u kërkohet për të përballuar një rrezik real dhe të çastit, që kërcënon atë ose një person tjetër (*PLSH, kolegë*) nga një dëmtim i rëndë, me kusht që të mos jetë i provokuar prej tij dhe dëmi i shkaktuar të mos jetë më i madh se dëmi i zmbropsur.

### **III.E drejta për përdorimin e armës së zjarrit**

Punonjësit e Gardës, në përmbushje të detyrave funksionale përkatëse, mund të përdorin armët e zjarrit nëse nuk ka mënyrë tjetër:

- a) për të mbrojtur jetën dhe shëndetin e tij, si dhe jetën e Personaliteteve në ruajtje (*personave të tjerë*) nga sulme të pashmangshme ose për të parandaluar vazhdimësinë e aktit kriminal, që shkakton rrezik të lartë për jetën;

b) për të zbrapsur sulmin ndaj objektit në ruajtje (*Seli, Rezidencë*), nëse është qartësisht e dukshme që jeta e personit, i cili e siguron atë, ose personave të tjerë (*P.L.SH, kolegë*) është në rrezik.

#### **IV.Paralajmërimi për përdorimin e armës së zjarrit**

1. Përpara përdorimit të armëve të zjarrit punonjësit e Gardës duhet të identifikojnë veten si të tillë, si dhe t'i japin një paralajmërim të qartë, duke u shprehur me zë të lartë "Ndal", ndjekur nga paralajmërimi i dytë "Ndal se do të qëlltoj", nëse ai nuk ndalet.

2. Atje ku është e mundur, përpara përdorimit të një arme zjarri, punonjësit e Gardës përdorues të armës, duhet të paralajmërojnë/të ndalojnë me zë të qartë dhe të vendosur personin që paraqet rrezikshmëri, që ai të heqë dorë qartazi nga realizimi i veprimit/veprimeve të tij. Vetëm kur personi që po kryen një ose disa veprime me rrezikshmëri të lartë tregon qartë se nuk ka dëshirë të ndërpresë veprimin e tij, atëherë punonjësi i Gardës (*përdoruesi i armës*) mund të hapë zjarr kundër tij duke bërë një qitje, e cila drejtohet/shënjestrohet duke synuar në pjesët e poshtme të trupit.

3. Në rrethana objektivisht të pamundura, të ngutshme, në rast se paralajmërimi rrezikon punonjësin e Gardës mund të mos bëhet paralajmërimi në rast se një veprim i tillë rrezikon punonjësin e Gardës ose personat e tjerë (*P.L.SH, kolegë*) nga një rrezik i çastit për jetën. Në këtë rast qëllohet pa paralajmërim, duke synuar në pjesët e poshtme të trupit.

4. Ndalohet e shtëna me qëllim paralajmërimi nga punonjësi i Gardës.

#### **V.Shmangia e rrezikut publik**

1. Përdorimi i armëve të zjarrit është i lejueshëm vetëm kundër personave të veçantë të armatosur, të cilët kryejnë vepra të dukshme dhune kundër jetës së P.L.SH (*sigurisë së P.L.SH-së dhe O.R.V-së*) ose/dhe shërbimeve që kryejnë strukturat e Gardës, kur përdorimi i masave të tjera shtrënguese nuk ka dhënë rezultatet e dëshiruara.

2. Përdorimi i armëve të zjarrit për të shmangur një rrezik publik, që paraqet një tubim i dhunshëm personash, është i lejueshëm vetëm kundër personave të veçantë të armatosur, të cilët kryejnë vepra të dukshme dhune kundër jetës së personit (*P.L.SH*) ose shërbimeve që kryen Garda e Republikës në O.R.V, kur përdorimi i masave të tjera shtrënguese nuk ka dhënë rezultatet e dëshiruara.

#### **VI.Ndalimet**

1. Arma nuk përdoret kur personi që paraqet rrezikshmëri përpiket të largohet, gjë që tregon synimin e tij për të hequr dorë nga realizimi i aktit kriminal dhe kur ky largim nuk paraqet kërcënim për pacënueshmërinë e personave të tjerë.

2. Ndalohet të qëlluarit në ajër me armë zjarri mbi grumbullime njerëzish, si një mënyrë për shpërndarjen e tyre.
3. Armët e zjarrit nuk mund të përdoren në asnjë rrethanë në rastin e protestave paqësore, qofshin ato të ligjshme apo të paligjshme.
4. Arma e zjarrit përdoret me Urdhër vetëm në kushtet e gjendjes së jashtëzakonshme të përcaktuar me Vendim të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

## **VII. Përgjegjësia për pasojat e përdorimit të armës**

1. Punonjësit e Gardës në momentet që përdorin armë zjarri, kanë përgjegjësi personale.
2. Përdorimi i armëve të zjarrit nga personeli i Gardës në kundërshtim me rregullat e përcaktuara në ligj, sjell përgjegjësi sipas Kodit Penal, sipas llojit të veprës penale të kryer.

## **VIII. Raste të tjera të përdorimit të armës**

Në përputhje me nenin 10 të Ligjit nr.72/2014 "Për përdorimin e armëve të zjarrit", lejohet përdorimi i armëve të zjarrit ndaj kafshëve, nga personeli i Gardës kur ato përbëjnë rrezik të menjëhershëm sulmi ndaj jetës ose rrezik për jetën dhe shëndetin e njerëzve nga sëmundje infektuese dhe kur:

- a) nuk është e mundur të kërkohet miratimi i pronarit të kafshës;
- b) kafsha nuk zotërohet nga asnjë person;

## **IX. Shembuj**

**A.** Arma e zjarrit përdoret si mjet ekstrem për të frenuar ose paralizuar veprimet e kundraligjshme të personit ose të personave të ndryshëm, kur mjetet e tjera nuk kanë dhënë rezultat, ose kur duket qartë se përdorimi i tyre nuk do të ketë sukses.

### **Konkretisht:**

Kur persona të ndryshëm përpiqen të futen forcërisht ose me automjete në Selitë dhe Rezidencat apo O.R.V të tjera, ose kur ata apo O.R.V-të sulmohen me armë dhe në rrethana konkrete sulmi nuk mund të sprapset me mjete të tjera, në këto raste përdoret arma e zjarrit.

**B.** Kur personeli i shërbimit në sektorin e shërbimit sulmohet befasisht me armë dhe rrethanat nuk lejojnë që ai të bëjë paralajmërimin e mësipërm, ai përdor armën pa paralajmërim në pjesët e poshtme.

### **Konkretisht:**

Pra, kur personeli i shërbimit vihet përball një sulmi të tillë me armë, të befasishëm ai hap zjarr në drejtim të personit që po e sulmon atë në atë vend që është ai (*sulmuesi*) pavarësisht se ai mund të jetë edhe jashtë O.R.V-së (*objektit në ruajtje*) duke u munduar në maksimum të shmangë dëmet anësore (*p.sh plagosjen e personave të tjerë që ndodhen pranë sulmuesit*).

C. Personeli i shërbimit në O.R.V e përdor armën e zjarrit për të mbrojtur jetën e tij në rast se ai sulmohet nga një sulm i padrejtë, i vërtetë dhe i castit me kusht që karakteri i mbrojtjes së tij të jetë në proporcion me rrezikshmërinë e sulmit me armë (**kushtet e mbrojtjes së nevojshme, Kodi Penal**)

#### **Konkretisht:**

Në rast se roja në vendshërbim apo sektor shërbimi të objektit në ruajtje sulmohet me armë nga një person apo disa, ai përdor armën në proporcion të drejtë me rrezikshmërinë e sulmit (*Kur ndërpritet sulmi ndërpritet dhe kundërpërgjigja*).

D. Personeli i shërbimit në O.R.V e përdor armën e zjarrit për të mbrojtur O.R.V, P.L.SH-në, jetën e kolegut në raste se ndaj këtyre, (*kolegut, O.R.V-së apo P.L.SH-së*) kryhet një sulm me armë dhe ata kërcenohen nga një rrezik real dhe i castit, apo nga një dëmtim i rëndë me kusht që të mos jetë i provokuar prej tij ose atyre, ku dëmi i shkaktuar të mos jetë më i madh se dëmi i sprapsur. (**kushtet e nevojës ekstreme, Kodi Penal**)

**Konkretisht:** Në rast se roja sheh që një apo disa persona janë duke qëlluar me armë zjarri (*pistoletë automatik, granatë, minë me telekomandë etj*), ndaj rojes tjetër, efektivit të grupit të shoqërimit, P.L.SH-së, apo vendosin eksplozivë në O.R.V apo makinë V.I.P dhe duan ta shpërthejnë këtë eksploziv, ai hap zjarr ndaj këtyre, pasi ata shmangin në këtë rast një vrasje apo një dëmtim të O.R.V-se ku nga ky dëmtim do të ndodhin dhe vdekja e personave të tjerë të cilët ndodhen brenda në këto objekte apo makina VIP.

E. Para përdorimit të armëve të zjarrit, personat ndaj të cilëve do të përdoret arma e zjarrit duhet të paralajmërohen me zë të lartë e të qartë. Kur personi nuk i bindet urdhërit, dhe reagon ndaj rojes me armë, qëllohet duke synuar pjesët e poshtme të trupit. Kur rrethanat nuk lejojnë në asnjë mënyrë bërjen e paralajmërimit, arma përdoret pa paralajmërim.

**Konkretisht:** Në rast se roja, kolegët apo P.L.SH-ja vihen menjëherë apo ndodhen përballë një sulmi të drejtëpërdrejtë me armë zjarri, atëherë ai hap zjarr pa paralajmërim në drejtim të tyre (*personave që sulmojnë*).

F. Në rast se personi apo personat që sulmojnë rojet në O.R.V apo vetë O.R.V-në ndërpresin, pushojnë, përfundojnë sulmin apo dorëzohen, atëherë ai (*roja*) duhet të ndërpresë përdorimin e armës së zjarrit ndaj tyre.

**Konkretisht:**Në rast se roja konstaton se në sektorin e shërbimit apo në afërsi të tij një grup personash në dukje gra, pleq e fëmijë theksojmë të *pa armatosur* tentojnë të hyjnë në sektorin e shërbimit dhe nuk përbëjnë rrezik serioz për jetën e tij atëherë, ai nuk mund ta përdorë armën e zjarrit ndaj tyre (*psh një grup gra e pleq të paarmatosur hyjnë në teritorin e vilës, pa pasur qëllim kërcënimit apo goditjen e P.L.SH-së ose O.R.V-së atëherë roja ndërmer masa të tjera operative duke lajmëruar përgjegjës të rojës, oficerin e Drejtimin apo Sallën Operative, pa pasur nevojë për përdorimin e armës*).

-Në rast se një person tenton apo kalon rrethimin e O.R.V duke hyrë në brendësi të sektorit të shërbimit dhe duket qarte që është i paarmatosur deri në momentin që ai nuk përbën rrezik serioz për jetën e tij (*rojes*), O.R.V- së apo P.L.SH- së (*personi mund të jetë i dehur ose ka ç'ekuilibrim mendor*) arma nuk përdoret ndaj tij, por merren masa të tjera operative. Në rastin ekstrem të përdorimit të armës së zjarrit, ajo përdoret në pjesët e poshtme të trupit të tij.